



Në bazë të Ligjit Nr. 08/L – 197 për zyrtarët publikë, Neni 39 (1,2,3,4,5 dhe 6) dhe Rregullores (QRK) NR. 15/2023 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovë, Neni 5 Komisioni i Pavarur i Minierave dhe Mineraleve shpall:

Konkurs

Pranim

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

Emri i grupit	Specialistë të inxhinierisë Elektrike
Titulli i pozitës së punës	Inspektor i Minierave
Klasa e pozitës	Profesional 1
Koeficienti/Paga	I 11-7
Nr. i kërkuar	1
Data e njoftimit	02/02/2024
Afati për aplikim	03/02/2024 - 03/03/2024
Institucioni	Komisioni i Pavarur i Minierave dhe Mineraleve
Departamenti	Departamenti i Inspektoratit
Divizioni	
Vendi i punës	Prishtinë
Nr. i Referencës	RN00013209
Kodi	RPC0006748



1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

- Inspektimi i aktiviteteve me Leje të aktiviteteve të veçanta për të konstatuar :
 - a) nëse kompania e cila ushtron këto aktivitete posedon Leje,
 - b) nëse kompania e cila posedon Leje, a i ushtron aktivitetet në përputhje me Lejen përkatëse, respektivisht me ligjet, rregulloret dhe dispozitat ligjore të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit.
- Inspektimi i aksidenteve me fatalitet (vdekjeprurëse) - lëndimeve të rënda, ne miniera, sipërfaqësore ,nëntokësore dhe objekte përpunuese .
- Kontrollimi i dokumentacionit teknik dhe pranimet teknike për Leje të aktiviteteve të veçanta
- Inspektimi i rregullt i minierave nëntokësore ,sipërfaqësore ,objekteve për përpunimin ,pasurimin e lëndës së parë minerale dhe stabilimenteve elektrike ne sektorin minerarë.
- Mbikëqyrja e aplikimit të masave të sigurisë dhe mbrojtjes në punë gjatë aktiviteteve minerare
- Inspektimi i aktiviteteve minerare ilegale dhe ndërmarrja e masave për parandalimin e tyre.
- Mirëmbajtja e rregullt e shënimeve të inspektimeve për lëshurjen e Lejeve ne objekte elektroenergjetike,perpunuese dhe stabilimente elektrike ne miniera sipërfaqësore dhe nëntokësore.
- Koordinimi i inspektimeve me institucionet tjera.
- Detyra të tjera – në përputhje me ligjet dhe rregulloret – të cilat me arsye mund të kërkohen kohë pas kohe nga mbikëqyrësi.

2.Kriteret e përgjithshme për pranimin në detyrë, sipas nenit 9 të LZP-së

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për veprim, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një veprës penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik.
- Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës.
- Të kaloj me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë ligj.



3. Kërkesat e përgjithshme formale

Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve, në Inxhinieri Elektroenergjetike: Diplomat nga universitetet e huaja duhet të jenë të nostrifikuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Kualifikime të posaçme formale: Diploma/Certifikata për programe Microsoft Office (Word, Excel etj).

Përvoja e punës e kërkuar: Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.

- Përvoja e punës duhet të përfshijë punën në sektorin elektroenergjetik.
- Përvoja e punës, përveç vërtetimit të punësimit duhet dëshmuar edhe me pasqyrën e llogarisë nga Trusti ose Rregullores në fuqi.

4. Njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara në procedurën e rekrutimit

- Të kenë njohuri të thelluara në aspektet metodologjike dhe aplikative dhe të jenë në gjendje ti përdorin këto njohuri për të interpretuar-kontrollu problemet e ndryshme në praktikë.
- Të njohin në përgjithësi dhe në thellësi fushat e Inxhinierisë Elektrike, në të cilat të jenë në gjendje të identifikojnë, formulojnë dhe zgjidhin problemet duke përdorur metoda, teknika dhe pajisje bashkëkohore.
- Të kenë aftësi e nevojshme për kontrollimin e rrjetit elektrik shpërndarës, rrjetave të furnizimit me energji elektrike të ndërmarrjeve dhe proceseve, që janë të lidhura ngushtë me fushën e mbrojtjes dhe automatizimit të Sistemit Elektroenergjetik dhe rrjetave të tjera të furnizimit me energji elektrike
- Të njohin përgjegjësitë e veta profesionale dhe etike
- Të kenë aftësi për organizimin, administrimin dhe aspektet ekonomike të ndërmarrjeve
- Të fitojnë aftësi vendimmarrëse dhe komunikimi.
- Njohja e gjuhëve zyrtare në vend, përparësi njohja e gjuhës angleze .
- Aftësi për përmbushjen e detyrave dhe punëve nën presion.

5. Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre

- Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore
- Kopjet e dëshmisë së punësimit
- Kopjet e dëshmisë së trajnimeve



6. Data e daljes së rezultateve të vlerësimit paraprak

- Lista e kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet për pranim do të shpallet më së largu deri më datën 18/03/2024, në portalin e rekrutimit elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

7. Kriteret specifike shtesë

8. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- Testimi me shkrim – maksimumi 70 pikë
- Intervista – maksimumi 30 pikë

9. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes email dhe portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

10. Mënyra e aplikimit

- Përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

11. Data e shpalljes së rezultateve përfundimtare

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

Të dhëna shtesë:

Nuk ka

Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre, personat me aftësi të kufizuar dhe gjinia më pak e përfaqësuar kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në LZP. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen

